

Udhëzimet e KCSF-së mbi kufizimet për financimin e organizatave të lidhura me personat e ekspozuar politikisht

Shumica e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë janë OJQ të regjistruara, disa nisma të paregjistruara dhe grupe joformale. Ndonëse natyra e tyre jofitimprurëse është element përcaktues, pavarësia nga “qeveria” është po ashtu njëjtë e rëndësishme. Kosova është ndër vendet që e kanë të theksuar në Ligj këtë duke ua ndaluar në mënyrë të qartë të gjitha OJQ-ve të regjistruara që të angazhohen në mbledhje fondesh ose në fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike (neni 34 i Ligjit për lirinë e asociimit në OJQ). Ndonëse ky kufizim vlen për OJQ-të si persona juridikë, ai nuk i përfshin individët e organizatës, përfshirë ata në pozita drejtuese.

Ndonëse e njëj rëndësinë e aktivitetit politik si metodë legjitime të qytetarëve për t’u angazhuar për interesat e tyre dhe të mirën e përbashkët, KCSF-ja është gjithashtu në dijeni për rreziqet që lidhen me një angazhim të tillë nëse ndodh brenda fushëveprimit të sektorit të shoqërisë civile. Kjo është posaçërisht sfiduese për OSHC-të që angazhohen në avokim për anëtarësitë e tyre ose çështje të interesit publik, pasi këtu mund të ketë një vijë të hollë që e ndan angazhimin e tyre publik në mes misionit të organizatës dhe interesave të organizatës politike me të cilën ai/ajo është i/e lidhur. Një rrezik i tillë bëhet më i qartë kur sigurohen burime financiare për OSHC-të për të zbatuar projekte ose për t’i forcuar organizatat e tyre me qëllim të avancimit të misioneve të tyre. Nëse individët e lidhur me organizata politike mbështeten financiarisht nga shoqëria civile, kjo mund ta rrezikojë reputacionin e organizatës dhe të donatorit, kauzën për të cilën ofrohet mbështetja dhe besimin e publikut në sektor. Kjo gjithashtu mund t’i devijojë fondet për qëllime të tjera, përveç atyre të deklaruara në misionin e organizatës dhe/ose propozimin e paraqitur. Nga ana tjetër, është e qartë që një rrezik i tillë është më i pranishëm për individët në pozita drejtuese në të dy sektorët sesa për anëtarët ose nëpunësit e rëndomtë qoftë të organizatave politike ose të OSHC-ve.


Në fund, përvoja në Kosovë e gjetiu tregon që përkatësia politike dhe ekspozimi nuk janë element i qartë që lidhet vetëm me mbajtjen e postit aktiv, por zakonisht vazhdon edhe pas kësaj periudhe. Kjo kërkon që ekspozimi politik të mos jetë i kufizuar vetëm për ata persona që mbajnë poste aktive, por të shtrihet në një periudhë të caktuar kohore që përfshin të paktën një cikël zgjedhor.

Bazuar në këtë që u tha më lart, KCSF-ja i ka përkufizuar shprehjen “persona të ekspozuar politikisht” (PEP) dhe ka caktuar disa kufizime për përfshirjen e tyre në aktivitete dhe/ose organizata të financuara nga skemat e KCSF-së për rigrantim, si mënyrë për ta zvogëluar rrezikun e tillë.

“Person i ekspozuar politikisht” do të thotë çdo person fizik, vendas ose i huaj, të cilit i është ose u janë besuar poste të larta publike, si:

- 1) President/e, Kryeministër/e, ministër/e, zëvendësministër/e, këshilltar/e politik/e, shef/e i/e kabinetit;
- 2) Deputetë të Kuvendit;
- 3) Anëtarë/e të organeve drejtuese/qeverisëse të partive politike, në nivel qendror ose lokal;
- 4) Anëtarë/e të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Supreme;
- 5) Ambasadorë/e ose të ngarkuar me punë në përfaqësim të shtetit ose zyrtarë të lartë ushtarakë;

Bashkëfinancuar nga:

- 
- 6) Kryetarë/e komunash, nënkryetarë/e komunash, drejtorë/e komunalë, këshilltarë/e politikë të kryetarëve dhe nënkryetarëve, shefa/e të kabinetit të kryetarëve dhe nënkryetarëve;
 - 7) Anëtarë/e të listës së partive politike që garojnë në zgjedhjet lokale ose nacionale;
 - 8) Anëtarë/e të kuvendeve komunale.

Personat në njërin prej posteve të cekura më lart konsiderohen PEP nëse janë në një post të tillë ose kanë qenë në një periudhë prej katër (4) vjetësh para datës së paraqitjes së kërkesës për financim në KCSF.

Për të pasur të drejtë për të aplikuar për fonde të KCSF-së, personat e tillë nuk duhet të jenë në pozita udhëheqëse në organizatën jo-qeveritare që aplikon, si Udhëheqës/e i/e Kuvendit të Anëtarëve, Udhëheqës/e ose anëtar/e i/e Bordit, Drejtor/e ekzekutiv/e, Menaxher/e (program ose financa) ose në ndonjë postë të ngjashëm të nivelit të lartë.

Gjatë fazës së aplikimit, të gjitha organizatave që aplikojnë u kërkohet të deklarojnë nëse ato bien në ndonjërin nga situatat që konsiderohen të papranueshme për shkak të përfshirjes së PEP-ëve në organizatën e tyre. Gjatë zbatimit, atyre u kërkohet ta njoftojnë KCSF-në për çdo ndryshim të këtij statusi. Mosdeklarimi i informacionit të vërtetë ose mosraportimi i ndryshimit të statusit mund të shpjerë në shpëputje të kontratës me efekt të menjëhershëm, në momentin kur KCSF-ja të jetë në dijeni për një rast të tillë.

Përveç kësaj, gjatë fazës së zbatimit, OSHC-të duhet të përmbahen nga lidhja e kontratave me PEP-ë (edhe si individë edhe përmes kompanive në pronësi të PEP-ëve) për aktivitete të financuara tërësisht ose pjesërisht nga KCSF-ja.